



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 98, Datë 16.04.2021

MBI

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY” SH.P.K.,  
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 13, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.04.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 47/4 prot., datë 12.04.2021 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për licencimin e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 80, datë 23.03.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të vendimmarrjes së ERE-s, me shkresën nr. 6/11 prot., datë 23.03.2021, është bërë publikimi në median e shkruar në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe në përfundim të afatit të njoftimit, nuk rezultoi të ketë patur vërejtje apo ankesa nga palë të interesuara.
- ERE me shkresën nr. 500 prot., datë 31.03.2021, ka njoftuar shoqërinë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., lidhur me vendimmarrjen e bordit, për fillimin e procedurave për licencimin e saj në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duke i bërë me dije nevojën për të depozituar dokumentacionin e konstatuar si të munguar, apo plotësuar pjesërisht sipas vendimit nr. 80/2021.

- Shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 500/1 prot., datë 08.04.2021, ka përcjellë të gjithë dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria ka kryer pagesën e regjistrimit për aplikim, për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, sipas Aneksit A, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”.
- Aplikimi i shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*” si më poshtë:
  - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”). Plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”). Plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”). Plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

#### **Vendosi :**

1. Të licencojë shoqërinë “DRAGOBIA ENERGY” në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**